

BULETIN PËR PËRCAKTIMIN E KONSULTËS PËR PRINDËRIT

Të ndruar Prindër

Nëse edhe tek Ju si në një familje me fëmijë vjen deri te ndarja ose divorci, kjo çon për të gjithë anëtarët e familjes drejtpërdrejtë në ndryshime të dhimbshme të cilat shpesh edhe nuk janë të lehta për ti kapërcyer.

Gjykata e rrethit, respektivisht gjykatësja kompetente e familjes ose gjykatësi familjes shfrytëzon mundësinë juridike për të përcaktuar një konsultim (këshillim). Qëllimi i këtij konsultimi është që ti detektoj problemet e familjes suaj dhe të kërkoj dhe gjejë një zgjidhje të mirëkuptuar për të gjitha palët e interesuara, prindërve dhe fëmijëve. Kjo Juve duhet të ju ndihmoj që më së miri ta tejkaloni këtë situatë të rëndë për Ju dhe fëmijët tuaj.

Konsultimi kryhet nga specialistët e Shërbimit Psikiatrik për fëmijë dhe të rinjë në St. Gallen ose nga Instituti i mjekësisë ligjore vlerësimi psikologjik ose nga shërbimi për ndihmën e fëmijëve dhe të rinjëve në St. Gallen. Kjo konsultë mundë të zgjasë rreth dy deri tre muaj, respektivisht deri në procedurën e ardhëshme gjyqësore dhe mund edhe të prolongohet, nëse nuk mund të garantohet një përfundim i kënaqshëm, por më shumë gjasa që ende të gjendet.

Nëse në fazën këshilluese nuk është e mundur zgjidhja konsensuale e problemit, gjykata pas dëgjimit të planifikuar por në prani të personit të konsultues menjëherë do të vendosë ose do të kërkoj sqarime të mëtejshme lidhur me këtë.

Ju lutemi të keni parasysh që pjesëmarrja në bisedimet, të cilat do të kryhen nga specialistët e këshillimit të lartpërmendur është i detyrueshëm për të dy prindërit dhe për fëmijët.

Ju së shpejti do të pranoni një ftesë fillestare për intervistë. Eksperti e ka për detyrë të ju këshillojë Juve dhe të gjithë personat tjerë të përfshirë dhe të ju ndihmojë për të gjetur një zgjidhje konsensuale. Eksperti nuk ka të drejtë të marrë vendime, por pas mbarimit të konsultës Gjykatës do ti dërgoj një raport mbi konsultën e kryer.

Harxhimet për ekspertizën do të llogariten sipas kohës së shpenzuar dhe do të barten nga prindërit, nëse këtyre nuk iu është lejuar udhëheqja e procedurës pa pagesë.

Për bashkëpunimin Tuaj konstruktiv, ne dëshirojmë të Ju falemenderojmë paraprakisht.